



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 20 korrik 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Skënder Hyseni, Shaip Muja, Donika Kadaj- Bujupi, Amir Ahmeti dhe Petar Miletqi.

Munguan: Enis Kervan dhe Sabri Hamiti.

Pjesëmarrës të tjerë: Tarkan Kosova– OSBE, Lumnije Murati- ZPRK dhe Besnik Ramadanaj-KDI.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të datave 8 dhe 23 qershor 2011;
3. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Grupit të Miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
4. Shqyrtimi i ftesës për vizitë në Republikën e Shqipërisë;
5. Miratimi i listës së ekspertëve për mbështetjen e punës së Komisionit;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të datave 8 dhe 23 qershor 2011;

Kryetari konstatoi se, Komisioni i miratoi procesverbalet e datave 8 dhe 23 qershor 2011;

3. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Grupit të Miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës;

Albin Kurti i njoftoi se Komisionit i është proceduar një propozim për formimin e Grupit të Miqësisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i nënshkruar nga 7 deputetë të Kuvendit. Sipas rregullës 6 të Rregullores së Kuvendit për formimin e grupeve të miqësisë, detyrë e Komisionit është që ta shqyrtojë propozimin dhe t'i rekomandojë Kryesisë së Kuvendit për nismën e formimit të grupit të miqësisë, të përbërë nga përfaqësues të secilit grup parlamentar.

Lidhur me këtë propozim dhe nevojën për inicime të reja të grupeve të miqësisë, diskutuan deputetët: Skender Hyseni, Hydajet Hyseni, Sh. Muja, D. Kadaj Bujupi dhe Amir Ahmeti. Pas diskutimeve të shumta, nga anëtarët e Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

T'i propozohet Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ta miratojë propozimin për formimin e Grupit të Miqësisë, në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e iniciuar nga një grup deputetësh.

Komisioni njëkohësisht i propozon Kryesisë së Kuvendit që të përpilojë një koncept për formimin e grupeve të miqësisë me kuvendet e shteteve të tjera, bazuar në Rregulloren përkatëse, për të cilin shpreh gatishmërinë dhe interesimin për të ndihmuar.

4. Shqyrtimi i ftesës për vizitë në Republikën e Shqipërisë;

Albin Kurti - Tha se ka arritur një shkresë nga Komisioni për Politikë të Jashtme i Republikës së Shqipërisë, përmes së cilës ftohet një delegacion i Komisionit tonë për vizitë zyrtare 2 ditore. Në shkresë nuk është përcaktuar numri i delegacionit për vizitë, e as data e vizitës, për të cilat duhet vendosur në Komision. Mbështeti realizimin e vizitës në Shqipëri dhe propozoi që delegacioni të jetë i përfaqësuar nga kryetari dhe dy nënkryetarët dhe nga një deputet prej secilit grup parlamentar.

Pas diskutimeve të shumta të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Të realizohet vizita zyrtare në Republikën e Shqipërisë, sipas ftesës së Komisionit homolog, në muajin shtator, në delegacion prej shtatë anëtarësh, të përbërë nga: kryetari, nënkryetarët dhe nga një deputet prej secilit grup parlamentar.

5. Miratimi i listës së ekspertëve për mbështetjen e punës së Komisionit

Albin Kurti – Lidhur me listën e ekspertëve tha se në mbledhjen e kaluar është vendosur që lista e ekspertëve të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit, së bashku me propozimet eventuale shtesë nga anëtarët e Komisionit. Deputetja Donika Kadaj - Bujupi e ka propozuar një kandidat, z. Argjend Zejnaj që t'i shtohet listës së ekspertëve.

Pas diskutimeve të shumta të anëtarëve të Komisionit, lidhur me listën e ekspertëve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Lista e ekspertëve për mbështetjen e punës së Komisionit të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

6. Të ndryshme

Albin Kurti - Për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës nr. 03/L-044, së bashku me Ligjin për plotësimin e ndryshimin e tij nr. 03/ L-207 njoftoj se grupi punues në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji ka mbajtur 2 takime të veta, ka identifikuar obligimet e Ministrisë lidhur me këtë ligj dhe ka realizuar një vizitë në MPJ, ku është takuar me personat më përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Në MPJ, tha se është realizuar një takim mjaft frytdhënës në interes të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit.

Në kuadër të obligimeve të Komisionit nga Plani i Veprimit të Kuvendit, njoftoi se Pika 1, e cila parashihet të përmbushet në tremujorin e dytë, do të përmbushet, edhe me një plotësim që në takimin e radhës me ministrin të kërkojmë nga ai edhe raport me shkrim, para mbledhjes së Komisionit. Ndërsa për obligimet të cilat parashihen në pikën 54, të cilat janë përcaktuara në tremujorin e tretë e të katërt të vitit 2011, mbetet që në sesionin vjeshtor të Kuvendit të punohen.

Në vazhdim njoftoi se Projektligji për marrëveshjet ndërkombëtare është proceduar në Kuvend, për të cilin Komisioni do ta shqyrtojë në cilësi të Komisionit Funkcional, si dhe propozoi që të ftohet ministri Hoxhaj, më 27 korrik 2011, për të përfunduar me çështjet e mbetura nga takimi i kaluar me ministrin.

Kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Në mbledhjen e radhës së Komisionit, më 27 korrik 2011, të ftohet ministri Enver Hoxhaj, për të vazhduar me çështjet e mbetura nga takimi i kaluar me ministrin.

Hydajet Hyseni - I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me pjesëmarrjen në një seminar të organizuar nga DCAF-i. Këtë seminar, të mbajtur në Zvicër, e konsideroi shumë të dobishëm, ngase janë diskutuar çështje të rëndësishme për Kosovën, si nga procesi i integriteteve evropiane, e po ashtu edhe nga politika e jashtme. Ai po ashtu shtroi çështjen e rishqyrtimit të Planit e Programit të Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor, mbështetur në fushëveprimtarinë e tij.

Donika Kadaj - Bujupi - Shprehu shqetësimin e një numri të qytetarëve tanë që jetojnë në Gjermani, të cilët nga konsullata e Kosovës atje, kanë vonesa të mëdha në marrjen e pasaportave të udhëtimit.

Duke u ndërlidhur me këtë çështje deputetët: SH. Muja, S. Hyseni dhe H. Hyseni, thanë se vonesat në lëshimin e dokumentit të udhëtimit mund të janë të ndikuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, fillimi rishtazi i lëshimit të dokumentit nga konsullata, mungesa e dokumentacionit të kompletuar, mungesa e letërnjoftimit dhe numri i madh i kërkesave të bëra për dokumentet e udhëtimit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti